



**UNIVERSITETI**  
**I SHKENCAVE TË APLIKUARA**  
— FERIZAJ —

Rektori  
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 2549/21; Datë: 10. 09.2021

Në bazë të nenit 48 paragrafit 1.4 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 10.09.2021, merr

**V E N D I M**

I.

Miratohet Rregullorja për Transfer të Studentëve në UShAF.

II.

Rregullorja hynë në fuqi nga dita e miratimit të saj.



**A r s y e t i m**

Senati i UShAF për qëllim të harmonizimit të rregulloreve me Statutin e UShAF pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF;
2. Njësive akademike të UShAF;
3. Arkivit të UShAF;

Rektori  
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI



Në bazë të nenit 48, paragrafit 1.4 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i USHAF në mbledhjen e mbajtur me datën 10.09.2021, miraton:

## **RREGULLORE PËR TRANSFER TË STUDENTËVE**

### **I. Dispozitat e përgjithshme**

#### Neni 1

Me Rregullore për transfer të studentëve (në tekstin e mëtejshëm: "Rregullore") në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: "Universiteti"), përcaktohen dhe rregullohen çështjet:

- Ndërrimi i programit të studimeve brenda Universitetit;
- Barazvlerësimi i planprogrameve;
- Procedurat administrative me rastin e transferit
- Transferi nga Institucionet tjera të Arsimit të Lartë
- Ekuivalentimi i notave dhe ECTS-kredive;
- Dispozitat kalimtare;

### **II. Ndërrimi i programit të studimeve**

#### Neni 2

Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në Fakultet apo nga një fakultet tjetër të Universitetit.

#### Neni 3

Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me dispozitat e Statutit.

### III. Barasvlerësimi i planprogrameve

#### Neni 4

Gjatë ndërrimit të programit të studimit studentit i lejohet legalisht të fillojë programin e ri të studimit nëse së paku 50% e provimeve janë dhënë me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.

#### Neni 5

Studentit i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve:

1. Më së paku në vitin e dytë të studimeve dhe atë në fillim të viti akademik vijues.

#### Neni 6

Ndërrimi i programit të studimit nuk mund të bëhet nëse studenti duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri.

### IV. Procedurat administrative me rastin e transferit

#### Neni 7

Studenti duhet t'ia dorëzojë kërkesën për ndërrimin e programit të studimit komisionit për studime të Fakultetit ku dëshiron të vazhdojë studimet. Bashkangjitur me kërkesën duhet të jetë pasqyra e notave në origjinal si dhe syllabuset për lëndët përkatëse bazuar në programin e mëparshëm të studimit.

#### Neni 8

1. Komisioni i studimeve përcakton detyrimet individuale për ndërrimin e programit të studimit në pajtim me rregullat e programit të studimit.
2. Vendimi për ndërrim të programit të studimit merret nga Këshilli Mësimor/Shkencor.
3. Ankesa kundër vendimit mbi refuzimin e ndërrimit të programit të studimit duhet t'i bëhet Senatit brenda 15 ditëve të punës pas publikimit të vendimit.
4. Senati brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës merr vendim përfundimtar në procedurë administrative.



## V. Transferi nga Institucionet tjera të Arsimit të Lartë (IAL)

### Neni 9

Gjatë ndërrimit të programit të studimit prej një (IAL) në Universitet, vlejné rregullat e njëjta si ato gjatë ndërrimit të programit të studimit brenda Universitetit ( Fakultetit) përveçëse studentët që bëjnë transfer nga IAL-të tjera, kërkesës duhet bashkangjitur dëshmia për akreditimin e programit të studimeve në të cilin kanë studiuar.

## VI. Ekuivalentimi i notave dhe ECTS-kredive;

### Neni 10

Pranimi i notave (ekuivalentimi) dhe ECTS- kredive të provimeve të dhëna me programin e ri të studimeve bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në rregulloret e studimeve bachelor dhe master nga Komisioni i studimeve, ndërsa vendimi merret nga Këshilli Mësimor/Shkencor.

## VII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

### Neni 11

Për çështjet të cilat nuk janë përfshirë me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës dhe Statutit të Universitetit.

### Neni 12

Kjo rregullore hynë në fuqi që nga dita e miratimit në Senat.

### Neni 13

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen me procedurë të njëjtë me atë të miratimit të saj.

### Neni 14

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja për transfer të studentëve nr. 43/20 e datës 09.01.2020.

Kryesuesi i Senatit të UShAF

Prof. Dr. Agron Bajraktari, Rektor